



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:039329

Datë: 29.01.2024

Numri i dokumentit: 05252650

Ac.nr.10395/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj, kryetare e kolegjit, Faton Ademi dhe Besnik Bislimaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditëses Q.A.M ,nga Fshati ... Komuna e Ferizajit, të cilën në bazë të autorizimit e përfaqëson L.Q.I, avokate nga Ferizaj, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “E.”, rr. “...”, NR... Prishtinë, të cilën në bazë të autorizimit e përfaqëson Vedat Kerolli, baza juridike kompensimi dëmit material dhe jo material, duke vendosur në lidhje me ankesën e paditëses dhe ankesën e të paditurës të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.573/20, i datës 16.09.2021 në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 26.01.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I.APROVOHEN pjesërisht të themelta ankesa e paditëses Q.A.M, nga Fshati ... Komuna e Ferizaj dhe ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “E.”, rr.”...”, NR... Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.573/20, i datës 16.09.2021, në pikën I sa i përket dhimbjeve fizike, frikës dhe kamatës dhe pika III të dispozitivit, NDRYSHOHET ashtu që tani gjykohet si në vijim: APROVOHET pjesërisht e themeltë kërkesëpadia e paditëses Q.A.M, nga fshati ..., Komuna e Ferizajt ashtu që DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “E.”, rr. ”...”, NR... Prishtinë, që paditëses Q.A.M, nga fshati ..., Komuna e Ferizajt t’ia paguajë shumë: për dëmin jo material; -në emër të dhimbjeve fizike shumë prej 1,200.00 euro; -në emër të frikës shumë prej 1,000.00 euro, ndërsa në emër të dëmit material – për ushqim të përforcuar shumë prej 112.00 euro ndërsa – në emër të kujdesit të personit të tretë shumë prej 150.00 euro, me kamatë në lartësi prej 8% në vit, ashtu që kamatën për dëmin jo material duhet t’ia paguajë që nga data e marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë me datë 16.09.2021, ndërsa për dëmin material kamatën duhet t’ia paguajë që nga dita e parashtrimit të padisë me datës 06.03.2020, e të gjitha

këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit e nën kërcënimin e përmbartimit me dhunë. REFUZOHET pjesërisht kërkesëpadia e paditëses Q.A.M, nga Fshati ... Komuna e Ferizajt përtej shumave të aprovuara sikurse në këtë pikë të dispozitivit të aktgjykimit për të gjitha format e dëmit, SI E PA THEMELTË.

II. REFUZOHET pjesërisht e pathemeltë ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve "E.", rr."...",NR... Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.573/20, i datës 16.09.2021, në pikën II, të dispozitivit, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.573/20, i datës 16.09.2021 ka vendosur si në vijim:

"I.PJESËRISHT APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Q.A.M, dhe DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve 'E.' që paditëses Q.A.M , t'ia paguaj shumat si në vijim: për dhimbjet e përjetuara fizike ,shumën prej 2000 euro, për frikën e përjetuar , shumën prej 1500 euro, të gjitha këto me kamatë prej 8 % në vit duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit 16.09.2021 e deri në pagesën definitive ,në emër të shpenzimeve mjekësore shumën prej 50.4 euro, të gjitha këto me kamatë prej 8 % në vit duke filluar nga data 21.01.2020 e deri në pagesën definitive , të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II.DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve 'E.' , që paditëses Q.A.M në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore tia paguaj shumat si në vijim :për përpilimin e padis 104 euro, për parashtrësën e precizimit të kërkesëpadisë 104 euro, për dy seanca të mbajtura 270 euro ,për taksën gjyqësore për padi 60 euro, për ekspertizë mjekësore 200 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

III.Refuzohet si e pabazuar pjesa e kërkesëpadisë së paditëses Q.A.M me të cilën ka kërkuar nga gjykata që detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve 'E.' që paditëses Q.A.M tia paguaj shumat si në vijim:, për përkujdesjen dhe ndihmën e huaj ,shumën prej 200 euro, për ushqim të përforcuar ,shumën prej 112 euro, për shpenzime të mjekimit 349.60,për dhimbje fizike 1600 euro, për frikën e përjetuar 600 euro të gjitha këto me kamatë prej 8 % në vit duke filluar nga data parashtrimin të kërkesës për kompensim e deri në pagesën përfundimtare."

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë kanë paraqitur:

Paditësja përmes të autorizuarit të saj, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën e parashtruar dhe ta ndryshoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ashtu që aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses dhe të obligohet e paditura që ti paguaj pjesën e refuzuar nga shkalla e parë.

E paditura përmes të autorizuarit të saj, për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën dhe aktgjykimin e atakuar ta prish dhe lëndën ta kthej në rivendosje, apo të njëjtin ta ndryshoj.

Përgjigje në ankesë nuk ka.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesat e palëve ndërgjyqëse janë pjesërisht të themelta.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, përmes të autorizuarit të tij, me datë 06.03.2020 në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi, të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit material dhe jo material, me arsye si në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.573/20, i datës 16.09.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se duke u bazuar në gjendjen faktike të vërtetuar ka nxjerrë përfundim se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e bazuar, dhe kjo gjykatë ka marr për bazë edhe dispozitën e nenit 183 të LMD-së, së Kosovës në lidhje me nenin 136 të LMD-së së Kosovës, sa i përket dëmit jomaterial. Sa i përket dëmit material nenin 136,të gjitha këto në lidhje me nenin 18 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia. Sa i përket pjesës së kërkesëpadisë së paditëses me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura që paditëses t'ia paguaj shumat : në emër të ushqimit të përforcuar ,shumën prej 112 euro, në emër të ndihmës së personit të tretë shumën prej 200 euro, për shpenzimet e mjekimit 349.60 euro, gjykata në këtë pjesë kërkesëpadinë e paditëses e ka refuzuar sepse paditësja nuk ka arritur ta vërtetojë faktin me prova, se me të vërtetë kanë bërë harxhime në emër të dëmit sipas këtyre bazave. Pjesën tjetër të kërkesëpadisë së paditëses me të cilën ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura që t'ia paguaj: në emër të dhimbjeve fizike 1600 euro, për frikën e përjetuar 600 euro, gjykata e ka refuzuar sepse e ka konsideruar të lartë në pajtim me kriteret e parapara me nenin 183.2 të LMD-së.

Vendimi për kamatën është bazuar në nenin 382.2 të LMD-së dhe Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës në lidhje me kamatën, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës Gjykata ka theksuar se e ka marrë bazuar në dispozitat e neneve 452.5 454.1,453.2 të LPK-së e ka detyruar të paditurën që paditëses t'ia kompensoi shpenzimet e procedurës ,si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar sa i përket shpenzimeve: për përfaqësimin e paditëses në seanca gjyqësore, për përpilim të parashtrësive, edhe në tarifën e OAK-ut të Kosovës.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës

zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës paditëse se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, bindës e në përputhje të plotë me arsyet e Aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Po ashtu nuk qëndron as pretendimi ankimor në raport me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike pasi që Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në provat e paraqitura nga vetë pala paditëse dhe pas administrimit të tyre ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike ashtu që nuk ka qenë kontestuese se me datën 25.12.2019 ka ndodhur aksidenti i trafikut ku automjeti “A” duke lëvizuar nga fshati D. për në drejtim të fshati Z. kur ka arritur në fshatin Z. nuk e ka përshtatur shpejtësinë e lëvizjes së kushteve të rrugës, kthesë e djathtë, vendbanim ashtu që ka humbur kontrollin ndaj timonit dhe ka kaluar në shiritin e kundërt të lëvizjes dhe me pjesën e përparme të djathtë e ka goditur në pjesën e përparme automjetin “B” të cilin ka qenë duke e drejtuar paditësja e cila ka qenë duke lëvizur në drejtimin e kundërt, dhe me këtë rast paditëses edhe i janë shkaktuar lëndime trupore si dhe dëme materiale në dy njësitë.

Ky fakt është vërtetuar edhe nga raporti i aksidentit si dhe raporti i policit hetues. Se paditësja ka pësuar lëndime trupore është vërtetuar edhe nga raporti i mjekut ku paditësja pas aksidentit ka kërkuar ndihmë mjekësore pranë Spitalit të Përgjithshëm – Qendra Emergjente në Ferizaj si dhe nga raporti mjekësor në Poliklinikën B.. Se paditësja ka pësuar lëndime të lehta trupore është vërtetuar edhe nga ekspertiza mjekësore e punuar nga eksperti E.XH –Ortoped traumatolog si dhe Dr. M.A –Psikiatër, të cilët kanë konstatuar se paditësja ka pasur lëndime të natyrës së lehtë që kanë shkaktuar dëmtime të përkohshme të shëndetit, dhimbje fizike ka pasur me intensitet të rëndë për 2 orë pas aksidentit, intensitet të mesëm të dhimbjeve 3 javë si dhe intensitet të ulët edhe 4 javë të tjera. Shëmtim trupor nuk ka pasur, ndërsa ndihma dhe përkujdesja e personit të tretë ka qenë e nevojshme 2 javë, kurse ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 3 javë. Ndërsa eksperti i psikiatrisë në ekspertizë ka theksuar se ka pasur frikë sekondare të intensitetit të lartë që ka zgjatur 1 javë, frikë sekondare të intensitetit të mesëm 2 javë si dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët edhe 4 javë.

Këto fakte nuk kanë qenë kontestuese nga palët ndërgjyqëse, pra baza juridike nuk është kontestuar mirëpo vetëm lartësia e saj, andaj pretendimet lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nuk janë të qëndrueshme dhe Gjykata e Apelit si të tilla i refuzon si të pa themelta.

Gjykata e Apelit duke i vlerësuar pretendimet ankimore të palëve ndërgjyqëse në raport me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, vlerëson se drejtë është zbatuar e drejta materiale në

pjesën vërtetuese të aktgjykimit sa i përket kompensimit të dëmit material në lidhje me shpenzimet e mjekimit.

Paditësja me anë të parashtresës me të cilën e ka precizuar kërkesëpadinë ka kërkuar kompensimin në shumë prej 400.00 euro për shpenzime të mjekimit, por Kolegji i kësaj Gjykate gjen se shuma e aprovuar prej 50,40 euro nga ana e Gjykatës së shkallës së parë për këtë kategori të dëmit përkon me shumën në faturat që paditësja i ka paraqitur pranë Gjykatës si prova. Në shkresat e lëndës gjenden faturat të cilat paditësja i ka sjellë dhe të cilat vërtetojnë se e njëjta ka pasur shpenzime mjekësore me rastin e shkakut të aksidentit, e në rastin konkret e paditura edhe e ka për obligim që të paguajë shpenzimet e mjekimit, pasi që paditëses i është shkaktuar dëm material, e njëjta ka pasur shpenzime pasi që ka pasur nevojë për mjekim, si kontrollat mjekësore etj., e që të njëjtat i ka vërtetuar me prova përkatëse –fatura që gjenden në shkresat e lëndës, ndërsa shuma e kërkuar prej 400.00 euro nga ana e paditëses sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit nuk mund të aprovohet në tërësi, pasi që e njëjta nuk e ka bërë të besueshme se ka shpenzuar këtë shumë të parave për mjekim, pasi që mungojnë provat në shkresat e lëndës që do të vërtetonin saktë se është shpenzuar shuma prej 400.00 euro.

Neni 177 paragrafi 2 i Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve përcakton se: *“Ai ka për detyrë të shpërblejë edhe shpenzimet e mjekimit të tij nga lëndimet e marrura dhe shpenzimet e tjera të nevojshme lidhur me mjekimin dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë”*. Andaj, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështje, Gjykata e Apelit vlerëson se në rastin konkret paditëses bazuar edhe në dispozitën e sipërcituar i takon shuma e aprovuar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të Gjykatës së shkallës së parë e të vërtetuar nga ana e Gjykatës së Apelit.

Gjykata e Apelit duke i vlerësuar pretendimet ankimore të palës paditëse dhe asaj të paditur, gjeti se qëndrojnë pretendimet sa i përket zbatimit të gabuar të së drejtës materiale lidhur me pjesën aprovuese në raport me shumën për kompensimin e dëmit jo material dhe në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë në raport me kompensimin e dëmit material.

Baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditëses, gjen mbështetje në nenin 136, 140, 159 paragrafi 1, dhe neni 183 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit i datës 10 Maj 2012, i cili ka hyrë në fuqi me datë 20 Dhjetor 2012.

Me nenin 136 të LMD-së, përcaktohet se: *“Kush i shkakton tjetrit dëm, ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*, me nenin 140 të këtij ligji, përcaktohet se: *“Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia”*, ndërsa me nenin 159 përcaktohet se: *“Në rast aksidenti të shkaktuar nga mjete motorik në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një zotëruesi zbatohen rregullat për përgjegjësinë në bazë të fajit”*.

Andaj gjykata e shkallës së lartë është bazuar në kuptimin e dispozitës së nenit 183 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së ku parashihet se : *1. Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të jetesës, të prishjes, të shkeljes së nderit ose të lirisë, të vdekjes së personit të afërm, si dhe për frikën, gjykata po të konstatojë se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhimbjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e justifikon këtë do të gjykojë*

kompensimin e dëmit material si dhe mungesa e dëmit material. 2. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se me të mos u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të përshtatshme me natyrën e saj dhe me qëllim shoqëror”.

Kjo Gjykate vlerëson se, shumat e aprovuar lidhur me kompensimin e dëmit jo material sa i përket dhimbjeve fizike dhe frikës nga ana e Gjykatës së shkallës së parë janë shuma të larta të cilat nuk përkojnë me shkallën e lëndimeve dhe intensitetin e frikës, meqenëse vetë gjykata e shkallës së parë i ka falur besimin ekspertizës së ekspertëve nga fusha e mjekësisë të cilët e kanë cilësuar si lëndim të lehtë trupor, shumat e gjykuara si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar sipas Gjykatës së Apelit janë të larta apo mbi nivelin e duhur në raport me lëndimet e shkaktuara, por njëkohësisht të larta edhe në raport me praktikën gjyqësore. Gjykata e Apelit vendosi si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për kategoritë e dëmit jo material dhe atë: për dhembjet fizike si dhe frikën e përjetuar pasi që vlerësoj se shumat e gjykuara nuk ishin në përputhje me qëllimin të cilit i shërbejnë kompensimit. Në çdo rast për dëmin jomaterial, gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimi tu shkoj përshtati qëllimeve që synohen me kompensimin e dëmit jo material e që është satisfaksion për të dëmtuarin. Mbi këtë bazë Gjykata e Apelit duke e pasur parasysh natyrën e lëndimeve që ka pësuar paditësja, llojin dhe kohëzgjatjen e dhembjeve fizike, frikën dhe mënyrën se si është manifestuar frika te paditësja si dhe rrethanat tjera, si moshën e paditëses dhe praktikën e mirë gjyqësore, e të cilat rrethana janë në pajtim të plotë me nenin 183 të LMD-së, vendosi si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit po ashtu vlerëson se gabimisht është zbatuar e drejta materiale kur Gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditëses sa i përket kompensimit të dëmit material për ndihmën dhe kujdesin e personit të tretë si dhe kompensimin për ushqimin e përforcuar, pasi që sipas vlerësimit të kësaj Gjykate këto nuk ka nevojë që të vërtetohen me prova konkrete, pasi që vetë Gjykata e shkallës së parë është bazuar në ekspertizën e ekspertëve të mjekësisë, e ku është konstatuar se paditësja ka pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë dhe për ushqim të përforcuar andaj pa dyshim se i takon kompensimi në përputhje me ditët që paditësja ka pasur nevojë për ndihmë të personit të tretë dhe ushqim të përforcuar, andaj shumat e aprovuara nga ana e kësaj Gjykate janë shuma adekuate duke pasur parasysh edhe praktikën gjyqësore si dhe dispozitat e LMD-së.

Gjykata e Apelit vendosi që të ndryshojë edhe kamatën lidhur me periudhën se prej kur duhet të rrjedhë e njëjta, ashtu që lidhur me dëmin material kamata duhet të rrjedhë që nga dita kur paditësi ka parashtruar padinë pasi që në atë moment e paditura ka qenë e njoftuar me dëmin e shkaktuar, ndërsa në raport me dëmin jo material kamata duhet të rrjedhë nga momenti i marrjes së aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë si moment i njoftimit të t' paditurës lidhur me dëmin jo material që i është shkaktuar paditësit, e krejt kjo konform nenit 382 të LMD-së, andaj edhe u vendos sikurse në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit.

Lidhur me shpenzimet e procedurës Gjykata e Apelit vlerëson se drejtë është vendosur dhe në përputhje me dispozitat e LPK-së, duke pasur parasysh suksesin e palëve në procedurë si dhe edhe faktin se vetë e paditura i ka dhënë shkas paditëses që të kërkojë mbrojtje gjyqësore.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe pretendimet e tjera ankimore, mirëpo vlerësoi se të njëjtat janë të pa bazuara dhe nuk kanë ndikim për vendimmarrje ndryshe nga ai sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura me lartë e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1 pika d) dhe e), e lidhur me nenin 201 paragraf 1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.10395/2021, me datë 26.01.2024

Kryetare e kolegjit
Hidajete Gashi Alaj, d.v.